

Marrëveshja e Financimit BNK për Programet Vjetore IPA II Kushtet e Veçanta versioni 1.2

MARRËVESHJA E FINACIMIT KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë dhe

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Kosovës* e përfaqësuar nga Ministria e Integritimit Evropian, që në vijim referohen bashkërisht si "Përfituesit e IPA II" ose veçmas si "përfituesja e IPA II" ose "pala",

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si "Palët"

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1 - Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin për alokimet e vitit 2018 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në Shtojcën I:

Programi i Veprimit të Bashkëpunimi Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2018 – 2020 (Numri i angazhimit (CRIS): 2018/041-401

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)¹.

2. Kostoja e totale e llogaritur për fondet e vitit 2018 të këtij Programi Veprimi është 1,411,764 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është vendosur 1.200.000 Euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e vendeve IPA II.

Neni 2 - Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Siç përcaktohet në nenin 1 (1) të Shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

¹ Rregullorja Nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon një Instrument për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

Marrëveshja e Financimit BNK për Programet Vjetore IPA II Kushtet e Veçanta versioni 1.2

2. Siç përcaktohet në nenin 1 (2) të Shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3 - Adresat dhe Komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar, duke iu referuar shprehimisht Programit të Veprimit, siç identifikohet në nenin 1 (1) dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin

Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin (DG NEAR)
Directorate D

Rue de la Loi 15

B-1049 Brussels

Belgjikë

Adresa e email-it: NEAR-D4@ec.europa.eu

b) për përfituesit e IPA II

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Bulevardi Gjergj Fishta, Nr 6

Tiranë, Shqipëri

Adresa e e-mail-it: info@mfa.gov.al

Ministria e Integritimit Evropian

Godina e Qeverisë, Kati 9, Zyra 905.910.

Rruga Nënë Tereza 10000 Prishtinë, Kosovë

Adresa e e-mail-it: mei@rks-gov.net

Neni 4 - Pikat e kontaktit të OLAF-it

Pikat e kontaktit e përfituesit IPA II që kanë kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), me qëllim lehtësimin e aktiviteteve të OLAF-it, do të jenë:

Z. Bejko Late

Drejtor i Sektorit të Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë, Shqipëri

Bejko.late@financa.gov.al

Dhe,

Znj. Dhurata Hoxha,
Ministër dhe Koordinatori Kombëtar IPA(KKIPA)
Ministria e Integritimit Evropian
Nene Tereza 14, Ndërtesa e re qeveritare, zyra 910
10000 Prishtinë
Email:dhurata.hoxha@rks-gov.net

Neni 5 - Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Shqipërinë nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi masat për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Kosovën nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi më datë 16 prill 2015, përkatësisht (më poshtë e/të referuar/a si “Marrëveshje(t) Kuadër).

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti midis dispozitave të Marrëveshjes së Financimit nga njëra anë, dhe dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse nga ana tjetër, do të kenë përparësi këto të fundit.

Neni 6 - Shtojcat

(1) Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

- a) Këto Kushte Specifike;
- b) Shtojca I: Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2018-2020 – [C(2018)8187];
- c) Shtojca IA: Programi IPA BNK Shqipëri -Kosovë;
- d) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;
- e) Shtojca III: Modeli i Raportit Vjetor BNK mbi zbatimin e asistencës IPA II (Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër;
- f) Shtojca IIIA: Modeli i raportit vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me Nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër;

(2) Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave nga njëra anë dhe dispozitave të Kushteve Speciale nga ana tjetër, do të kenë përparësi këto të fundit. Në rast konflikti midis dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA nga njëra anë dhe dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, do të zbatohen këto të fundit. Në rast konflikti midis dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA, do të zbatohen dispozitat e para.

Neni 7 – Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi datën në të cilën Komisioni merr njoftim nga vendi i fundit përfitues i IPA II, i cili konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi. Komisioni duhet të informojë përfituesit IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi. Nëse Komisioni nuk merr njoftim deri më 31 dhjetor 2019, Marrëveshja e Financimit nuk hyn në fuqi.

Kjo Marrëveshje është hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat një do i dorëzohet Komisionit dhe dy të tjerat përfituesve IPA II.

Për përfituesit IPA II:

Z. Sokol Dedja
Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme
Koordinatori Kombëtar i IPA-s

Tiranë, Datë

Znj. Dhurata Hoxha
Ministre e Integrimit Evropian
Koordinatore Kombëtare e IPA-s

Datë:

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtoreshë D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit
dhe Fqinjësinë
Komisioni Evropian

Bruksel, Datë